



# BURIMET

## SHOQATA AMERIKANE E KANCERIT (AMERICAN CANCER SOCIETY, ACS)

[cancer.org/cancer/ovarian-cancer.html](https://cancer.org/cancer/ovarian-cancer.html)

Misioni i ACS është të eliminojë kancerin si një problem madhor i shëndetit nëpërmjet kërkimit, edukimit, advokimit dhe shërbimit. ACS ofron informacion mbi parandalimin, trajtimin dhe mbështetjen, si dhe fakte/statistika mbi kërkimet dhe kancerin.

Broshura e ACS e vitit 2018, Fakte dhe Shifra për Kancerin (Cancer Facts and Figures) ka një seksion të veçantë për kancerin e vezores.

---

## QENDRAT PËR KONTROLLIN DHE PARANDALIMIN E SËMUNDJEVE (CENTERS FOR DISEASE CONTROL AND PREVENTION, CDC)

[cdc.gov/cancer/ovarian/index.htm](https://cdc.gov/cancer/ovarian/index.htm)

CDC ofron statistika me informacione bazë (faktorët e rrezikut, simptomat, trajtimin) dhe një mori burimesh rreth kancerit të vezores.

Në bashkëpunim me Zyrën për Shëndetin e Grave të Departamentit Shëndetësor dhe Shërbimeve Njerëzore, krijoi fushatën “Inside Knowledge: Get the Facts About Gynecologic Cancer” Informacione të besueshme: Mësoni fakte rreth kancerit gjinekologjik për të rritur ndërgjegjësimin për pesë llojet kryesore të kancerit gjinekologjik. Postera dhe burime të tjera të disponueshme për praktikatat.

---

## PROVAT KLINIKE

[clinicaltrials.gov](https://clinicaltrials.gov)

CDC ofron statistika me informacione bazë (faktorët e rrezikut, simptomat, trajtimin) dhe një mori burimesh rreth kancerit të vezores.

Në bashkëpunim me Zyrën për Shëndetin e Grave të Departamentit Shëndetësor dhe Shërbimeve Njerëzore (Department of Health and Human Services’ Office on Women’s Health), krijoi fushatën “Inside Knowledge: Get the Facts About Gynecologic Cancer” (Informacione të besueshme: Mësoni fakte rreth kancerit gjinekologjik) për të rritur ndërgjegjësimin për pesë llojet kryesore të kancerit gjinekologjik. Postera dhe burime të tjera të disponueshme për praktikatat.

---

## FORCË PËR T’U PËRBALLUR ME RREZIKUN E KANCERIT (FACING OUR RISK OF CANCER, FORCE)

[facingourrisk.org](https://facingourrisk.org)

Misioni i FORCE është përmirësimi i jetës për individët dhe familjet e prekura nga kanceri i trashëgueshëm i gjirit dhe i vezores ose nga lloje të tjera kanceri që lidhen me to. Mbështetja lokale në Miçigan ofrohet në Detroit dhe Ann Arbor. Programet përfshijnë:

- Mbështetje nga personat e tjerë që po kalojnë të njëjtë gjë.
- Forume
- Mbështetje lokale (vullnetarë në terren)
- Linjë ndihme pa pagesë (vullnetarë të trajnuar në 48 orë) për një këshilltar gjenetik të certifikuar nga bordi
- Regjistër të dhënash me në qendër pacientin
- Mjet për kërkimin e studimeve kërkimore (përputhje e pacientit me studimin)
- Programi i trajnimit për advokuesit në fushën e kërkimit
- Portali MËSO MË SHUMË (KNOW MORE)
- XRAYS (financuar nga CDC), i cili përkthen raportet mbi kërkimet e reja për kancerin e gjirit në gjuhë të kuptueshme nga pacientët
- Broshura
- Galeri fotosh pas mastektomisë.



# BURIMET

## FONDACIONI PËR KANCERIN E GRAVE (FOUNDATION FOR WOMEN'S CANCER)

[foundationforwomenscancer.org](http://foundationforwomenscancer.org)

Një organizatë jofitimprurëse e krijuar për të zhdukur kancerat gjinekologjikë përmes ndërgjegjësimit, diversitetit dhe përfshirjes, edukimit, partneritetit dhe kërkimit.

Broshura dhe materiale të tjera edukative për gratë që kanë ose që janë të rrezikuara për të pasur kancer gjinekologjik. Mësoni më shumë rreth kurseve të FWC për gratë që i kanë mbijetuar kancerit.

## DEPARTAMENTI SHËNDETËSOR DHE I SHËRBIMEVE NJERËZORE NË MIÇIGAN (MICHIGAN DEPT. OF HEALTH AND HUMAN SERVICES, MDHHS)

[michigan.gov/mdhhs](http://michigan.gov/mdhhs)

Departamenti Shëndetësor dhe i Shërbimeve Njerëzore në Miçigan (MDHHS) ndodhet në të 83 kontetë e Miçiganit dhe ofron një sërë shërbimesh për banorët e Miçiganit nëpërmjet trembëdhjetë zyrave dhe departamenteve. Ato zhvillojnë dhe inkurajojnë rezultate të matshme për shëndetin, sigurinë dhe vetëmjaftueshmërinë, të cilat reduktojnë dhe parandalojnë risqet, promovojnë barazinë, nxisin zakone të shëndetshme dhe transformojnë sistemin shëndetësor dhe të shërbimeve njerëzore për të përmirësuar jetën e familjeve të Miçiganit.

## ALEANCA E MIÇIGANIT PËR KANCERIN E VEZORES (MICHIGAN OVARIAN CANCER ALLIANCE, MIOCA)

[mioca.org](http://mioca.org)

MIOCA është degë e NOCC me bazë në Miçigan. Faqja e burimeve ka burime financiare specifike për Miçiganin, të tilla si Angels of Hope.

## RRJETI KOMBËTAR GJITHËPËRFSHIRËS PËR KANCERIN (NATIONAL COMPREHENSIVE CANCER NETWORK, NCCN)

[nccn.org/patients/guidelines/content/PDF/ovarian-patient.pdf](http://nccn.org/patients/guidelines/content/PDF/ovarian-patient.pdf)

NCCN ofron udhëzime për ofruesit e kujdesit dhe pacientët me kancer, si dhe një bibliotekë me video rreth trajtimeve.

Udhëzimet për kancerat gjinekologjikë përfshijnë udhëzime për kancerin:

- E qafës së mitrës
- E tubave të fallopit (vezores)
- Endometrial
- Vulvar

Gjithashtu, NCCN ofron udhëzime për zbulimin, parandalimin dhe reduktimin e rrezikut për vlerësimin gjenetik/familjar me rrezik të lartë: kanceri i gjirit, i vezores dhe i pankreasit.



# BURIMET

## **KOALICIONI KOMBËTAR PËR KANCERIN E VEZORES (NATIONAL OVARIAN CANCER COALITION, NOCC)**

[ovarian.org](http://ovarian.org)

Misioni i NOCC është të parandalojë dhe kurojë kancerin e vezores, si dhe të përmirësojë cilësinë e jetës për të mbijetuarit. Mund të gjeni informacion për:

- Shenjat dhe simptomat
- Diagnozën
- Trajtimin dhe
- Rikthimin

---

## **ALEANCA PËR KËRKIMIN MBI KANCERIN E VEZORES (OVARIAN CANCER RESEARCH ALLIANCE, OCRA)**

[ocrahope.org](http://ocrahope.org)

Aleanca për Kërkimin mbi Kancerin e Vezores (OCRA) është shoqata bamirëse më e madhe globale e dedikuar në avancimin e kërkimit për kancerin e vezores duke mbështetur gratë dhe familjet e tyre.

Burime në faqen e tyre të internetit përfshijnë:

- Informacion për kancerin e vezores
- Informacion për të sapodignostikuarit
- Informacion për provat klinike
- Burime për pacientët
- Informacion për gratë e reja
- Informacion për konferencën kombëtare të kancerit të vezores
- Informacion rreth mbështetjes nga personat që janë në të njëjtën situatë

Burimet për pacientët përfshijnë:

- Informacion të përgjithshëm, prova klinike të trajtimeve, mbështetje financiare
- Gjetja e një prove klinike (mësoni rreth, mite, pyetje të shpeshta)
- Një fjalorth me terma
- Uebinare
- Pamje grafike me informacione rreth kancerit të vezores (mund të shkarkohen/printohen)

Mbështetje për kancerin e vezores:

- Punonjës socialë në fushën e onkologjisë nga e hëna në të premte, ora 12:00-15:00 ET 212.268.1002
- Kërkoni Tracy; do t'ju telefonojmë brenda 24 orësh
- Mbështetur nga grante
- Programi i mbështetjes nga gratë për gratë – të mbijetuar vullnetarë